

# GUIDË PËR STUDENTËT E RINJ



## UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

[www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al)



## Fjala përshëndetëse e Rektores së Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Prof. dr. Suzana Golemi

*Të nderuar studentë,  
Mirë se vini në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi"!*

Ky Universitet, me përvojë mbi 60-vjeçare, është institucioni i vetëm arsimor në zonën veriore të vendit tonë.

Universiteti i Shkodrës ofron personel akademik të kualifikuar, i cili përbën asetin me potencialin më të rëndësishëm, programe të shumta studimi, që sigurojnë tregun e punës, infrasktrukturë moderne, laboratorë të shumtë, bibliotekë dixhitale, e cila pasurohet me literaturë bashkëkohore në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj.

Gjithashtu, Universiteti i Shkodrës, ofron dy qendra kërkimore-shkencore, bazuar në konceptin e mësimdhënies së orientuar drejt kërkimit, krijimit dhe ofrimit të dijeve, promovimit të vlerave dhe përqafimit të ideve inovative. Ne jemi përgjegjës për të siguruar vazhdimësinë e diversitetit dhe cilësinë e duhur të mësimdhënies.

Universiteti ynë ka diplomuar breza profesionistësh, shumë të kualifikuar në shkencat humane, mjekësore, të natyrës, kompjuterike, ekonomike dhe juridike, të cilët janë punësuar në një treg global të barabartë me çdo student tjetër në botë.

Në veprimtarinë arsimore dhe kërkimore, studentët, si themeli i çdo veprimtarie në Universitet, kanë përfaqësuesit e tyre në vendimmarrjet e institucionit. Gjithashtu, studentët tanë, mund të shfaqin dhe zhvillojnë aftësitë e tyre në sport dhe arte, duke marrë pjesë në projekte të ndryshme. Jeta studentore është e gjallë dhe e mbushur plot me arritje në arsim dhe shkencë, ekspedita dhe aktivitete të kohës së lirë. Auditorët tanë janë gjithmonë të hapur për ju.

Vitet e jetës studentore janë ndër vitet më kryesore në formimin tuaj. Shumica prej nesh e ka provuar që diplomimi në një universitet të bën një person tjetër, më të pjekur, më të formuar, më të frymëzuar në aspektin profesional, ashtu edhe personal. Tani është radha juaj të nisni këtë rrugëtim emocionues. Ne do t'ju mbështesim në çdo hap të rrugës suaj gjatë viteve të studimit.

Suksesi juaj akademik është po aq i rëndësishëm si për ju, ashtu edhe për ne. Ne ju sigurojmë që Universiteti do të vazhdojë të mbetet një vend që promovon mendimin e hapur dhe të lirë, për zhvillimin e së ardhmes së shoqërisë sonë, duke prodhuar studentë kompetentë, të informuar dhe produktivë.

Është kënaqësi e madhe për mua t'ju mirëpres në këtë vit të ri akademik 2020-2021 në Universitetin tonë dhe t'ju uroj:

Paçi fat në rrugëtimin tuaj!

Shfrytëzoni të gjitha mundësitë!

Rrugëtimi fillon tani!



## HISTORIKU I UNIVERSITETIT TË SHKODRËS

- 02.09.1957** U themelua Instituti Pedagogjik 2 vjeçar i Shkodrës me Fakultetin e Shkencave të Natyrës
- 28.05.1991** Fiton statusin ligjor si Universitet, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
- 01.09.1991** U themelua Fakulteti i Shkencave të Edukimit
- 28.03.1991** U themelua Fakulteti i Shkencave shoqërore
- 13.05.1996** U themelua Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Drejtësisë
- 31.01.2001** U themelua Fakulteti i Gjuhëve të huaja



# FAKULTETET

## 1. FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

- Departamenti i Biologji –Kimisë,
- Departamenti i Fizikës,
- Matematikë-Informatikë
- Departamenti i Infermierisë
- Qendra e Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës

## 2. FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

- Departamenti i Mësuesisë
- Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale
- Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve
- Departamenti i Arteve

## 3. FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

- Departamenti i Gjuhës shqipe,
- Departamenti i Letërsisë
- Departamenti i Historisë
- Departamenti i Gjeografisë
- Qendra e Studimeve Albanologjike

## 4. FAKULTETI I DREJTËSISË

- Departamenti i të Drejtës Publike
- Departamenti i të Drejtës Civile
- Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane

## 5. FAKULTETI EKONOMIK

- Departamenti i Administrim-Biznesit
- Departamenti i Financë-Kontabilitetit
- Departamenti i Turizmit.

## 6. FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

- Departamenti i Gjuhës Angleze
- Departamenti i Gjermanistikës
- Departamenti i Romanistikës

Aktualisht, USH-ja ofron 59 programe studimi të ndryshme në 3 ciklet e studimit.

- Cikli i parë - Bachelor (26 programe studimi)
- Cikli i dytë - Master i Shkencave (13 programe studimi) & Master Profesional (17 programe studimi)
- Cikli i tretë - Doktoraturë (1 program studimi)

Gjithashtu, ofron Program studimi me karakter profesional 2 vjeçarë dhe 1 vjeçarë


- Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike
- Udhërrëfyes turistik dhe menaxhues i itinerareve turistike në Rajonin Verior të Shqipërisë

Universiteti i Shkodrës është licensuar me VKM Nr. 150, datë 18.04.1957 si Instituti i Pedagogjik 2-vjeçar i Shkodrës dhe VKM Nr.124, datë 28.05.1991 si Universiteti "Luigj Gurakuqi".

Akredituar:  
Vendim i ASCAL  
Nr. 03,  
datë 24.01.2020

Duke studiuar në USH, studentët kanë pasur mundësinë të mësojnë me më shumë se 600 pedagogë me kohë të plotë dhe 1000 pedagogë të jashtëm si dhe të ftuar, dhe 13 303 studentë janë diplomuar në USH nga 1959-2007 në sistemin 4-vjeçar, dhe 21690 studentë të diplomuar në sistemin e Bolonjës dhe 1325 studentë të diplomuar në Programet "Master Shkencor", 2199 studentë në Programet "Master Professional" dhe 13 në "Shkollën Doktorale".

# STAFI AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË



- Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" është partner në programe të Bashkimit Evropian si Erasmus +, IPACross Border, CEEPUS etj.
- Gjatë tre viteve të fundit, 70 studentë kanë realizuar mobilitetin e tyre me një semestër (6 muaj) në kuadër të Erasmus +, Credit Mobility në shtetet Itali, Gjermani, Letoni, Austri, Kroaci, Republika Çeke, Bullgari, Spanjë, Poloni, Portugali. Të gjitha shpenzimet për këto shkëmbime janë mbuluar nga fondet e Bashkimit Evropian.
- Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" respekton të drejtat e studentëve që i përkasin kategorive të veçanta dhe i mbështet ato gjatë procesit mësimor duke i lehtësuar aksesin në mësimdhënie dhe duke krijuar ambiente të përshtatshme që janë gjithnjë në përmirësim, ka mbështetur aktivitetet kulturore, sportive, kërkimore shkencore të studentëve.



Dekan: Prof. as. dr. Rrok Smajlaj  
eMail: rrok.smajlaj@unishk.edu.al

zv.Dekan: Doc. dr. Julian Kraja  
eMail: julian.kraja@unishk.edu.al

Sekretare e Dekanit:  
**Rudina (Bushati) Meraja**  
eMail: rudina.meraja@unishk.edu.al

## FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

**F**akulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) si njësi kryesore e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" e nisi veprimtarinë e vet mësimore dhe shkencore, me themelimin e Institutit të Lartë Pedagogjik, më 2 shtator 1957.

### MISIONI:

Është përgatitja dhe formimi cilësor i studentëve në të gjitha ciklet e studimit si dhe kërkimi shkencor në fushat përkatëse, në mënyrë që të shfrytëzojnë burimet dhe kapacitetet e vendit në përputhje të plotë me strategjinë dhe perspektivën e zhvillimit. Rezultatet e frytshme të bashkëpunimit tonë me institucionet e mirënjohura arsimore në Europë dhe SH.B.A japin sigurinë e plotë të një perspektive të qartë të fakultetit tonë.

### POLITIKA E CILËSISË

Fakulteti i Shkencave të Natyrës u ofron studentëve mundësinë të studiojnë dhe të punojnë me një staf akademik të përkushtuar dhe u ofron programe mësimore bashkëkohore me nivel të lartë shkencor, gjithmonë në ndryshim. Në auditoret tona gjatë studimeve, studentët ndjejnë energji pune dhe përkushtim të plotë nga stafi akademik i fakultetit.

# FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

## ÇFARË OFRON FAKULTETI?

- Promovimin e kërkimit dhe studimeve të avancuara në fusha të ndryshme teorike dhe aplikative në biologji kimi, matematikë, fizikë dhe shkencat mjekësore.
- Promovimin e filozofisë të të mësuarit të studentëve që përgatiten për profesione specifike.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së shkollës (studimeve) pasuniversitare ku të mundësohet studimi i thelluar në fusha me interes praktik e teorik.
- Organizimi i stafit akademik në grupe studimi dhe kërkimi shkencor në fusha të përafërta duke rritur mundësinë e kualifikimit të specializuar të stafit si dhe bashkëpunimit mes tyre për të realizuar projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme me departamente të ngjashme të shteteve të tjera me qëllim nxitjen e bashkëpunimit në drejtim mësimesor e kërkimor.
- Të sigurojë në shumicën e lëndëve projekte grupi dhe projekte individuale që simulojnë situata që do të hasin studentët në ambientet e punës në të ardhmen.
- Përditësimi i programeve mësimore dhe fushave të kërkimit duke i vendosur në të njëjtën linjë me sfidat e përcaktuara nga Bashkimi Europian në lidhje me shoqërinë e informacionit.
- Përgatitja e trajnimit të mësuesve të biologji kimisë, matematikës dhe fizikës informatikës në arsimin parauniversitar dhe aftësimi i tyre për t'ju përgjigjur sfidave të zhvillimit të teknologjisë së informacionit.
- Të nxisë të mësuarit gjatë gjithë jetës duke inkurajuar punën individuale përtej njohurive që zhvillohen në auditoret e shkollës
- Konsolidimin e mjaft arritjeve të punës shkencore në fushat e studimit të Departamenteve si dhe zgjerimi i tyre, sidomos në fushën mjedisore dhe mjekësore
- Kualifikimi i punonjësve mësimesor dhe stafit ndihmës pedagogjik, si dhe përmirësimi i teknikave të mësimdhënies me anë të përdorimit të pajisjeve dhe teknikave audiovizive bashkëkohore
- Nxitja e të mësuar aktiv dhe në mënyrë të pavarur, duke i dhënë përparësi realizimit të punëve laboratorike, projekteve e detyrave të kursit dhe sidomos punimeve të diplomave.
- Studentët e diplomuar në programet e studimit të FSHN të jenë të aftë të demonstrojnë kompetenca teknike në shkencat natyrore dhe mjekësore



## **PROGRAMET E STUDIMIT:**

### **1. DEPARTAMENTI I MATEMATIKES:**

- a) Bachelor në "Matematikë" me 180 pikë kredite.
- b) Bachelor në "Informatikë" me 180 pikë kredite.
- c) Master Profesional në "Matematikë me profil Minor në Informatikë", me 120 pikë kredite.
- d) Master Profesional në "Informatikë me profil Minor në Matematikë", me 120 pikë kredite.
- e) Program studimi me karakter profesional në "Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike", me 120 pikë kredite.

### **2. DEPARTAMENTI I BIOLOGJI KIMISË:**

- a) Bachelor në "Biologji-Kimi", me 180 pikë kredite.
- b) Master Profesional në "Biologji-Kimi", me 120 pikë kredite.
- c) Master i Shkencave në "Biologji Mjedisore", me 120 pikë kredite.

### **3. DEPARTAMENTI I FIZIKËS:**

- a) Bachelor në Fizikë, me 180 pikë kredite.
- b) Master Profesional në "Matematikë e Fizikë" me 120 pikëkredite.

### **4. DEPARTAMENTI I INFERMIERISË:**

- a) Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme", me 180 pikë kredite.
- b) Bachelor në "Infermieri (Mami)", me 180 pikë kredite.
- c) Bachelor në "Fizioterapi", me 180 pikë kredite.
- d) Master Profesional në "Psikologji Shëndeti", me 60 pikë kredite.





Dekan: Prof. as. dr. Fatmir Vadohej  
eMail: fatmir.[vadohi@unishk.edu.al](mailto:fatmir.vadohi@unishk.edu.al)

zv/Dekan:  
Prof.as.dr. Fatbardha Osmanaga  
eMail: fatbardha.omanaga@unishk.edu.al

Sekretare Dekanit: Klodiana Prenga  
eMail: klodiana.prenga@unishk.edu.al

## FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

**F**akulteti i Shkencave të Edukimit i ka filluar e tij në vitin akademik 1981 – 1982, me hapjen e programit të studimit për Mësues për klasat I – IV të shkollës 9 – vjeçare (Cikli Ulët). Po në këtë vit akademik, u krijua, për herë të parë, në USH, katedra e Psikologjisë dhe Pedagogjisë, e cila merret me problemet e Degës së mësuesisë për Ciklin e Ulët.

### MISIONI:

Formimi i studentëve me njohuritë më bashkëkohore për një përgatitje cilësore dhe konkurrente si mësues për Arsimin fillor, Arsimin parashkollor dhe mësues të edukimit fizik. Synon të përgatisë specialiste të këshillimit psikologjik, të fushës së psikologjisë dhe punonjës sociale. Në fushën e artit synon të përgatisë specialistë në Pedagogjinë muzikore dhe në artet pamore. Të aftë për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit e të vendit dhe si dhe në kërkimin shkencor

### POLITIKA E CILËSISË:

Të mbajë dhe zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigures i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioriteteve të zhvillimit të vendit.

## ÇFARË OFRON FAKULTETI?

- Kurrikula të pasura dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, (cikli I dhe Cikli II), në zbatim të Deklaratës së Bolonjës, legjislacionit për Arsimin e Lartë dhe udhëzimeve të MASR, në përputhje me nevojat e tregut, që i siguron studentëve mundësi për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë e nevojshme praktike.
- Staf akademik i kualifikuar me tituj e grada shkencore; profesionalizëm dhe përkushtim i tij për t'u përballuar me sfidat me qëllim përmbushjen e qëllimeve që ka FSHE.
- Nivel i lartë i punës kërkimore - shkencore i pedagogëve dhe i aktivitetit të tyre botues.
- Monitorimi i përvitshëm i cilësisë së mësimdhënies.
- Numër i lartë i aktiviteteve të realizuara nga pedagogët më studentë (orët e hapura; të ftuar specialistë të fushës).
- Marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes lokale dhe shërbimet e ofruara nga OJF – të, ku zhvillohen praktikatat profesionale të studentëve.
- Bashkëpunim i vazhdueshëm i FSHE me komunitetin akademik, e më gjerë.

## PROGRAMET E STUDIMIT:

### 1. DEPARTAMENTI I MËSUESISË:

- a) Cikli i parë i studimit, (Bachelor) në "Mësuesi për Arsimin Fillor", me 180 pikë kredite.
- b) Cikli i parë i studimit, (Bachelor) në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", me 180 pikë kredite.
- c) Master Profesional në "Mësuesi për Arsim Fillor", 120 pikë kredite.
- d) Master i Shkencave në "Mësuesi në Biologji - Kimi me Profil Minor në Karriera dhe Aftësimi për Jetën", 120 pikë kredite.

### 2. DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË DHE PUNËS SOCIALE:

- a) Cikli i parë i studimit, (Bachelor) në "Psikologji" me 180 pikë kredite.
- b) Cikli i parë i studimit, (Bachelor) në "Punë Sociale", me 180 pikë kredite.
- c) Master i Shkencave në "Psikologji Klinike", me 120 pikë kredite.
- d) Master i Shkencave në "Psikologji Organizative", me 120 pikë kredite.
- e) Master Profesional në "Shërbimet Sociale", me 60 pikë kredite.

### 3. DEPARTAMENTI I EDUKIMIT FIZIK E I SPORTEVE:

- a) Cikli i parë i studimit, (Bachelor) në "Edukim Fizik dhe Sporte", me 180 pikë kredite.
- b) Master Profesional në "Edukim Fizik dhe Sporte", me 120 pikë kredite.

### 4. DEPARTAMENTI I ARTEVE:

- a) Cikli i parë i studimit (Bachelor)-Programi i studimit në "Pedagogji Muzikore", me 180 pikë kredite.
- b) Cikli i parë i studimit (Bachelor)-Programi i studimit në "Pikturë dhe Grafikë", me 180 pikë kredite.



Dekan: **Prof.dr. Artan Haxhi**  
Email: artan.haxhi@unishk.edu.al

Zv. Dekan: **Prof. as. Dr. Nevila Dibra**  
eMail: nevila.dibra@unishk.edu.al

Sekretare e Dekanit:  
**Doriana (Shpori) Deda**  
eMail: doriana.deda@unishk.edu.al

## FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

**F**akulteti i Shkencave Shoqërore është një prej themelvënësve të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe e ka gjenezën e tij që në vitin 1957, vit kur u hap për herë të parë Instituti i Pedagogjik 2 vjeçar i Shkodrës. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 28. 05. 1991 Universiteti fitoi statusin që ka sot dhe brenda tij Fakulteti i Shkencave Shoqërore nisi jetën si njësi e veçantë me dy drejtime studimi: Gjuhë shqipe – Letërsi dhe Histori – Gjeografi. Pranë këtij fakulteti është ngritur dhe funksionon Qendra e Studimeve Albanologjike. Me Urdhërin nr. 498, dt. 07. 10. 2011 në vitin akademik 2011-2012 u hap shkolla doktorale "Gjuhë shqipe". Ajo synon të kryejë studime komplekse në fushë të gjuhësisë, si në rrafshin sinkronik, ashtu edhe në atë diakronik.

### MISIONI:

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka si mision formimin dhe kualifikimin e studentëve në të gjitha ciklet, përgatitjen e historianëve, gjeografëve, gjuhëtarëve, letrarëve e gazetarëve të rinj. Ky fakultet synon formimin e mësuesve të kualifikuar në shërbim të shoqërisë, të albanologëve të rinj me standarde të larta në kërkimin shkencor.

### POLITIKA E CILËSISË:

Fakulteti i Shkencave Shoqërore kujdeset për cilësinë e mësimdhënies në arsimin e lartë në të gjitha ciklet, vepron në fushën e formimit kulturor dhe profesional dhe synon gjithashtu formimin dhe përditësimin e njohurive.

## ÇFARË OFRON FAKULTETI?

- Programe studimi në dy ciklet e studimit dhe për Gjuhën shqipe deri në nivel doktorature.
- Kurrikula të larmishme dhe të përditësuara duke iu dhënë mundësi studentëve të përballen lehtësisht dhe të jenë të suksesshëm në tregun e punës.
- Staf akademik të kualifikuar dhe me përvojë akademike, që ofron një mësimdhënie cilësore.
- Personalitete nga fushat kërkimore që mbulojnë për leksione të hapura dhe bashkëpunim në kërkimin shkencor.
- Përfshirja e gjithë stafit të fakultetit jo vetëm në procesit mësimor, por edhe në kërkimin shkencor me botimeve me vlerë në fushat përkatëse.
- Bashkëpunim të ngushtë student-pedagog dhe mbështetje e vazhdueshme e studentëve.
- Lidhje e teorisë me praktikën përmes ekspeditave, laboratorëve dhe punëve praktike.
- Mobilitet të studentëve në kuadrin e projekteve të ndryshme.
- Bashkëpunim me simotrat brenda dhe jashtë vendit, qendra të rëndësishme kërkimore.

## PROGRAMET E STUDIMIT:

### CIKLI I PARË


- Bachelor në "Gjuhë-Letërsi", me 180 pikë kredite.
- Bachelor në "Histori", me 180 pikë kredite.
- Bachelor në "Histori dhe trashëgimi kulturore", me 180 pikë kredite
- Bachelor në "Gjeografi", me 180 pikë kredite.
- Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim", me 180 pikë kredite.
- Program studimi me karakter profesional në "Udhërrëfyes turistik dhe menaxhues i itinerareve turistike në Rajonin Verior të Shqipërisë", me 60 pikë kredite.

### CIKLI I DYTË

- Master i Shkencave "Studime të Thelluara në Gjuhësi", me 120 pikë kredite.
- Master i Shkencave "Etnokulturë dhe Letërsi Shqipe", me 120 pikë kredite.
- Master i Shkencave "Studime Regjonale në Gjeografi", me 120 pikë kredite.
- Master i Profesional në "Mësuesi në Gjuhë-Letërsi", me 120 pikë kredite.
- Master i Profesional në "Mësuesi Histori-Gjeografi", me 120 pikë kredite.

### CIKLI I TRETË

- Shkollë doktorale në "Gjuhë shqipe"



Dekan: **Dr. Gasper Kokaj**  
email: [gasper.kokaj@unishk.edu.al](mailto:gasper.kokaj@unishk.edu.al)

Zv. Dekane: **Dr. Yllka Rupa**  
email: [yllka.rupa@unishk.edu.al](mailto:yllka.rupa@unishk.edu.al)

Sekretare e Dekanit: **Edona Curraj**  
email: [edona.curraj@unishk.edu.al](mailto:edona.curraj@unishk.edu.al)

## FAKULTETI I DREJTËSISË

**F**akulteti i Drejtësisë i USH-së është themeluar në vitin 1992. Programi i studimit 4-vjeçar në Drejtësi (mbi bazën e të cilit, sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në RSH të vitit 2007, u kalua në programin e studimit 3-vjeçar Bachelor në Juridik) është hapur me VKM nr. 349, datë 10.08.1992 "Për hapjen e degës së Drejtësisë dhe Administrim-Biznesit në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër".

### MISIONI:

Fakulteti i Drejtësisë ka si mision t'u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme dhe specifike profesionale dhe shkencore në përshtatje me tregun e punës në fushën e të drejtës për administratën publike dhe profesionet e lira. Ndër objektivat formuese është mundësia e aftësisë së studentëve për të analizuar dhe kombinuar normat juridike, përveç aftësisë në argumentimin e përshtatshëm për zgjidhjen e çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta të nevojshme për specialitetin përkatës në tregun e punës.

### POLITIKA E CILËSISË:

Të mbajë dhe zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigures i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioriteteve të zhvillimit juridik të vendit.

# ORGANIZIMI I FAKULTETIT TË DREJTËSISË

Fakulteti është i organizuar në 3 njësi bazë:

1. Departamenti i të Drejtës Publike,
2. Departamenti i të Drejtës Civile,
3. Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane.

## ÇFARË OFRON FAKULTETI:

1. **Diplomë studimesh të integruara Master i Shkencave në Drejtësi me 300 pikë kredite me kohëzgjatje 5 vite akademike.**

Studentët që kryejnëstudimet e integruara në drejtësi mund të konkurrojnë për t'u përgatitur si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, avokatë të shtetit, përmbarues privatë ose shtetërorë, si dhe nëpunës në administratën gjyqësore ose juristë në administratën publike, pasi të kenë kryer provimin e shtetit në drejtësi.

2. **Master i Shkencave në të Drejtën Kushtetuese dhe Administrative me120 pikë kredite**

Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin e këtij programi studimi synojnë të plotësojnë formimin e kandidatëve për t'u përfshirë në sektorë ku kërkohen njohuri të posaçme për të drejtën kushtetuese dhe administrative, në kuadër të së drejtës së brendshme në përshtatje me legjislacionin ndërkombëtar dhe evropian përkatës, në përputhje me kërkesat e procesit të integritit evropian.

3. **Master i Shkencave në të Drejtën Private dhe e Biznesit me 120 pikë kredite**

Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin e këtij programi studimi synojnë të plotësojnë formimin e kandidatëve për t'u përfshirë në sektorë ku kërkohen njohuri të posaçme për të drejtën private dhe të biznesit.

## PROGRAMET E STUDIMIT:

1. Program i Integruar i ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi", me 300 pikë kredite.
2. Master i Shkencave në "E Drejta Kushtetuese dhe Administrative", me 120 pikë kredite.
3. Master i Shkencave në "E Drejta Private dhe e Biznesit", me 120 pikë kredite.



Dekan:

**Prof.as.dr. Blerta (Spahia) Dragusha**

eMail: [blerta.dragusha@unishk.edu.al](mailto:blerta.dragusha@unishk.edu.al)

Zv.Dekan:

**Prof.as.dr.Albana (Begani) Boriçi**

eMail: [albana.borici@unishk.edu.al](mailto:albana.borici@unishk.edu.al)

Sekretare e Dekanit:

**Fatbardha (Meraja) Myrtja**

eMail: [fatbardha.myrtja@unishk.edu.al](mailto:fatbardha.myrtja@unishk.edu.al)

## FAKULTETI EKONOMIK

**F**akulteti Ekonomik i USH-së është themeluar në vitin 1993, me Vendimin nr. 349, datë 10.8.1992 të MASH, mbi bazën e shkollës amerikane të biznesit dhe mbështetjen e Universitetit të Ilinoisit të Jugut, Carbondale dhe Universitetit të Nebraskës në SHBA.

### MISIONI:

Fakulteti Ekonomik ka mision formimin e studentëve me njohuritë më bashkëkohore duke synuar përgatitjen e tyre si menaxherë, financierë, kontabilistë dhe specialistë në fushën e turizmit të aftë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të komunitetit e të vendit dhe si dhe në kërkimin shkencor dedikuar fushës së ekonomisë.

### POLITIKA E CILËSISË:

Të mbajë dhe zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigurues i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioriteteve të zhvillimit ekonomik të vendit

# ÇFARË OFRON FAKULTETI?

- Një kurrikulum i pasur dhe i larmishëm programesh mësimore në të dy ciklet e studimeve, në përputhje me nevojat e tregut, që i siguron studentëve mundësi për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë praktike.
- Pjekuria e profesionalizmi, përkushtimi i një personelit akademik dinamik për t' i përballuar me sukses sfidat në përmbushje të misionit të fakultetit.
- Mbështetje nga profesorë të ftuar vendas dhe huaj që pasurojnë programet tona duke ndarë përvojat e tyre.
- Mundësi kombinimi të vazhdueshëm të njohurive teorike me praktikën profesionale në organizata biznesi, institucione të ndryshme sipas fushës së studimit.
- Studime universitare që zhvillohen në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.
- Mundësi për të marrë pjesë në programet mësimore të ofruara nga FE edhe për studentët e trojeve shqiptare.
- Bashkëpunim i FE me universitete në Evropë dhe në SHBA për kërkim shkencor, mobilitete për stafin akademik dhe studentët e këtij fakulteti.
- Bashkëpunim i vazhdueshëm i FE me komunitetin akademik, autoritetet e qeverisjes qendrore e vendore, komunitetin e biznesit, dhe OJQ në realizimin e misionit të tij.
- FE është e vendosur në zemër të rajonit verior të Shqipërisë, në qytetin e Shkodrës

## PROGRAMET E STUDIMIT:

### 1. DEPARTAMENTI I ADMINISTRIM- BIZNESIT:

- a) Bachelor në "Administrim-Biznes", me 180 pikë kredite.
- b) Master Profesional në "Administrim Biznes", me 120 pikë kredite.
- c) Master i Shkencave në "Administrim Biznesi", me 120 pikë kredite.

### 2. DEPARTAMENTI I TURIZMIT:

- a) Bachelor në "Turizëm", me 180 pikë kredite.
- b) Master i Shkencave në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm", me 120 pikë kredite.
- c) Master Profesional në "Trashëgimi Kulturore dhe Manaxhim Turizmi", me 120 pikë kredite.

### 3. DEPARTAMENTI I FINANCË- KONTABILITET:

- a) Bachelor në "Financë- Kontabilitet", me 180 pikë kredite.
- b) Master i Shkencave në "Kontabilitet", me 120 pikë kredite.
- c) Master i Shkencave në "Financë", me 120 pikë kredite.
- d) Master Profesional në "Financë-Bankë", me 120 pikë kredite.
- e) Master Profesional në "Menaxhimi Financiar, Kontabiliteti dhe Kontrolli në Administratën Publike", me 60 pikë kredite.





Dekan: **Prof.asoc.dr. Edlira Bushati**  
eMail: [edlira.bushati@unishk.edu.al](mailto:edlira.bushati@unishk.edu.al)

zv. Dekan: **Dr. Alva Dani (Halluni)**  
eMail: [alva.dani@unishk.edu.al](mailto:alva.dani@unishk.edu.al)

Sekretare e Dekanit:  
**Fatjona Troshani**  
eMail: [fatjona.trashani@unishk.edu.al](mailto:fatjona.trashani@unishk.edu.al)

## FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

**F**akulteti i Gjuhëve të Huaja i USH-së është krijuar si njësi qendrore më vete në vitin 2001, me Vendimin MASH, dt. 31.01.2001, mbi bazën e Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe Departamentit të Gjermanistikës. Sot ai ka tre departamente, përkatësisht Departamentin e Anglistikës, Departamentin e Gjermanistikës dhe Departamentin e Romanistikës.

### MISIONI:

Formimi i studentëve të nivelit BA me njohuritë më bashkëkohore duke synuar përgatitjen e tyre si specialistë në fushën e gjuhësisë, letërsisë, ndërkulturorit dhe përkthimit të aftë për të kryer punë kërkimore edhe në rrafshet krahasimore mes gjuhës dhe kulturës së studiuar dhe asaj shqipe.

Formimi i studentëve të nivelit MA me metodologjitë dhe teknikat më bashkëkohore dhe të njohura në fushën e mësimdhënies së gjuhës së huaj.

### POLITIKA E CILËSISË:

Të ruajë standardet dhe të zhvillojë më tej rolet dhe synimin e fakultetit si siguresi i cilësisë në arsimimin e brezave në funksion të kërkesave për specialistë dhe përkthyes të gjuhëve të huaja.

## ÇFARË OFRON FAKULTETI?

- Një kurrikule të pasur dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, BA dhe MA, të hartuara më mbështetjen e fortë dhe të qëndrueshme të universiteteve dhe institucioneve partnere në bashkërendim me nevojat e tregut, që i siguron studentëve mundësi për të fituar njohuritë më të përditësuara në fushën akademike dhe aftësitë praktike.
- Një kurrikulë të bashkërendim me kërkesat dhe parimet evropiane që mundëson lëvizshmërinë e studentëve në programe studimi jashtë vendi me mundësi ekuivalentimi.
- Formim, përkushtim, korrektësi dhe profesionalizëm të stafit akademik (një pjesë e mirë jashtë vendit) për të përballuar dhe përmbushur me sukses sfidat dhe detyrimet në përmbushje të misionit të fakultetit dhe për t'u formuar në vazhdimësi.
- Mbështetje nga profesorë dhe personalitete të ftuar, vendas dhe huaj, nga universitetet partnere që pasurojnë programet tona, duke bashkëndarë përvojat e tyre me stafet e FGJH-së, përmes leksioneve të hapura dhe konferencave që realizohen me nisma të përbashkëta.
- Ndërthurje e shkëlqyer e njohurive teorike me ato praktike, përmes materialeve autentike që u ofrohen studentëve të nivelit BA dhe praktike që realizojnë studentët MA.
- Bashkëpunime të frytshme me Universitete Evropiane, që ofrojnë mundësi të shkëlqyera studimi përmes akordimit të bursave për studentët dhe përvoja shkëmbimi dhe pasurimi profesional për stafin akademik.
- Klimë pozitive bashkëpunimi mes stafit akademik dhe studentëve. Në fakultetin tonë mirëpritën studentët e trojeve me kuota të veçanta.

## PROGRAMET E STUDIMIT:

### 1. DEPARTAMENTI I ROMANISTIKËS:

- Bachelor në "Gjuhë Italiane", me 180 pikë kredite.
- Bachelor në "Gjuhë Frënge", me 180 pikë kredite.
- Master në "Mësuesi në Gjuhë Italiane", me 120 pikë kredite.
- Master në "Mësuesi në Gjuhë Frënge", me 120 pikë kredite.

### 2. DEPARTAMENTI I ANGLISTIKËS:

- Bachelor në "Gjuhë Angleze", me 180 pikë kredite.
- Master në "Mësuesi në Gjuhë Angleze", me 120 pikë kredite.

### 3. DEPARTAMENTI I GJERMANISTIKËS:

- Bachelor në "Gjuhë Gjermane", me 180 pikë kredite.
- Master në "Mësuesi në Gjuhë Gjermane", me 120 pikë kredite.



## HISTORIKU I BIBLIOTEKËS SHKENCORE TË UNIVERSITETIT “LUIGJ GURAKUQI”

- Biblioteka Universitare ka filluar veprimtarinë e saj që me krijimin e Institutit Pedagogjik Shkodër në vitin 1957.
- Sot kjo bibliotekë ka një fond prej rreth 111 mijë libra, gazeta, kasete, cd dhe dvd në shqip dhe gjuhë të huaj, që mbulojnë të gjitha fakultetet e Universitetit “Luigj Gurakuqi”.
- Godina aktuale e bibliotekës e ndërtuar në vitin 2006, ka një arkitekturë bashkëkohore me tre kate dhe një sipërfaqe rreth 3000 m<sup>2</sup>.
- Biblioteka ofron për përdoruesit e saj një sërë shërbimesh: informacion dhe huazim, mediatekën me 26 vende multimedia, tre salla leximi me 300 vende leximi në total. Salla e konferencave “Ëalter Hoeflechner”, ka një kapacitet me 120 vende, duke mundësuar zhvillimin e një sërë aktiviteteve me karakter akademik, mësimdhënës apo promovues.
- ❖ Biblioteka ofron një shërbim bashkëkohor edhe në rrugë elektronike përmes adresave që mund të aksesohen nga websiti i saj: [www.bush.unishk.edu.al](http://www.bush.unishk.edu.al)



## PALESTRA E UNIVERSITETIT TË SHKODRES “LUIGJ GURAKUQI”

- Palestra e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është ndërtuar në vitin 2003.
- Është një ndërtesë polivalente që disponon dy ambjente ku zhvillohen sportet e rënda dhe fitness –aerobia si dhe salla e madhe 30mx20m(600m<sup>2</sup>) gjithsej 750 m<sup>2</sup>, ku zhvillojnë mësimin praktik rreth 300 studentë të Degës së Edukimit Fizik e Sporte në lëndët e: basketbollit, volejbollit, gjimnastikës dhe orët praktike të lëndëve metodike të edukimit fizik.
- Ndërtesa është e pajisur dhe me ambjentet ndihmëse si banjo, dhomat e zhveshjes si për vajza dhe për djem dhe magazina e materialeve sportive.
- Kjo palester ka ndihmuar shumë në rritjen e aktivitetit të universitetit duke zhvilluar veprimtari të ndryshme sportive të organizuara nga Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte. Këto veprimtari kanë ndikuar në përmirësimin e jetës aktive të studentëve duke i dhënë mundësi që të zhvillojnë aktivitete sportive brenda universitetit por dhe shkembime sportive me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.

# PROJEKTET

## ERASMUS+ CAPACITY BUILDING NE USH

Ne kuadër të thirrjes për aplikime per projektet Erasmus+ Capacity Building per vitin 2020, Universiteti i Shkodrës do të jetë pjese e projekteve te mëposhtme fituese te cilat fillojne zbatimin ne fillim te viti 2021.

**1** . *Sustainable University - Enterprise Cooperation for Improving Graduate Employability (SUCCESS)*. Mandati i këtij projekti është firmosur me datë 24.01.2020 dhe Lead partner eshte Universiteti i Burch, Bosnje-Hercegovine.

Objektivi i pergjithshem i projektit është: Modernizimi i universiteteve të vendeve të Ballkanit Perendimor përmes forcimit të partneritetit Universitet-Sipermarrje në fushat e arsimit dhe transferimit të njohurive bazuar në nevojat e tregut me qëllim të përmirësimit të punësimit të studentëve. Për më tepër, projekti synon të forcojë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rrjetëzimin në nivelin rajonal / ndërkombëtar midis universiteteve dhe ndërmarrjeve.

**2** . *Entrepreneurial skills for a Modern Education in Albania, EntrAL*. Mandati i këtij projekti është firmosur me datë 11.12.2019 dhe Lead partner eshte Universiteti i Turkus, Finlandë.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është: Të rritet mendësia e sipërmarrjes në Institucionet Shqiptare të Arsimit (IAL-të dhe shkollat) për të mbështetur aftësitë e të diplomuarve që përputhen me kërkesat e jetës së punës dhe shoqërisë moderne. Për këtë arsye projekti synon të sjellë një mentalitet sipërmarrës në universite dhe shkolla, duke inkurajuar metodat sipërmarrëse të mësimdhënies dhe të ushqejë sjelljet sipërmarrëse të studentët dhe të mbështesë krijimin e start-up të studentëve. Profesorët do të mbështeten nga struktura dhe mekanizmat e universitetit (LLL, aktivitete për stafin); studentët do të marrin nga profesorët e tyre mbështetje dhe këshilla më të mira në lidhje me sipërmarrjen dhe aftësitë që lidhen me sipërmarrjen, duke mbështetur punësimin e tyre pas diplomimit.

**3** . *"Inclusive tertiary Education in Western Balkans – IDEA" Capacity - Development in pursuit of Equity and Accessibility of HEIs in the Wester Balkans for Students with Disabilities and/or Learning Difficulties*". Mandati është firmosur me datë 16.01.2020 dhe Lead partner është Universiteti Polis, Shqiperi.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit të propozuar është përmirësimi i qasjes, krijimi i kushteve gjithëpërfshirëse të të nxëniet në arsim dhe zhvillimin e mundësive të punësimit për studentët me aftësi ndryshe dhe vështirësi në të mësuar në Ballkanin Perëndimor. Mjeti për të realizuar këtë synim gjithëpërfshirës është ndërtimi i kapaciteteve të Njësisë të Shërbimit Studentor, fakultetit, administratës, studentëve dhe organeve drejtuese të IAL-ve bashkëpunuese të vendeve partnere dhe Ministrive përkatëse të Arsimit, zhvillimi i praktikave moderne të përfshirjes, teknologjive ndihmëse dhe rrjetëzimit, të cilat do të përfitojnë gjithashtu grupe të pafavorizuara në nivele më të ulëta arsimore (arsimi fillor dhe i mesëm).

**4**. *MSc. Course in STEAM education – STEAMedu*. Mandati është firmosur me datë 16.01.2020 dhe lead partner është Universiteti i Mostar, Bosnje- Hercegovine. Ky projekt synon hapjen e një programi studimi të nivelit të dytë (master) në shkencat STEAM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Art dhe Matematikë). Në këtë kontekst, projekti do të hulumtojë se si të forcohet arsimimi STEAM, duke siguruar një plan udhërrëfyes dhe adresuar zhvillimin e një eko-sistemi arsimor në zhvillim, duke përfshirë kurrikulën e MSc, shërbimet e bashkëpunimit me palët e interesuara dhe procedurat e vlerësimit të vazhdueshëm. Konsorciumi do të adoptojë një qasje hibride, në lidhje me kërkimin shkencor, veprimtarinë dhe partnerët do të kontribuojnë si për objektivat specifike të vendit ashtu dhe për ato të BE-së për vitin 2020

**5**. "University to Society Infomediaries in Albania: Co-Production of knowledge and research that matters" / U-SIA. Mandati është firmosur me date 20.01.2020 dhe Lead partner është Universiteti Mesdhetar, Shqipëri.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxisë një universitet efektiv dhe të qëndrueshëm për bashkëpunimin e shoqërisë në Shqipëri me ndikim në procesin e zhvillimit dhe integritimit evropian të vendit. Në mënyrë të veçantë, projekti synon: SO1 - për të rritur kapacitetet e universiteteve në Shqipëri për të bashkë-prodhuar njohuri dhe kërkime me ndikim përmes krijimit të njësisë së brokerimit të transferimit të njohurive dhe inovacionit (USIA). SO2 - të prezantojë dhe zgjerojë bashkë-prodhimin e njohurive që janë akademikisht të nevojshme dhe praktikisht të zbatueshme në kontekstin shqiptar përmes krijimit të një rrjeti partnerësh në modelin Helix Quadruple (QH).

# FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

## DEPARTAMENTI I GJUHESISE

### ***Përgjegjëse e departamentit***

Prof. as. dr. Orjeta Baja

orjeta.baja@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof. dr. Mimoza Prik

mimoza.priku@unishk.edu.al

Prof. as. dr. Rrezarta Dracini

rrezarta.dracini@unishk.edu.al

Dr. Merita Hysa

merita.hysa@unishk.edu.al

Dr. Rezearta Murati

rezearta.murati@unishk.edu.al

Dr. Aida Uruçi

aida.uruci@unishk.edu.al

Dr. Anisa Kosteri

anisa.kosteri@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I LETËRSISË

### ***Përgjegjës i departamentit***

Prof.as.dr. Arben Prendi

arben.prendi@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof.dr. Ledri Kurti

ledri.kurti@unishk.edu.al

Prof. as. dr. Vincens Marku

vincens.marku@unishk.edu.al

Prof.as.dr. Valbona Karakaçi

valbona.karakaci@unishk.edu.al

Prof. as. dr. Elindë Dibra

elinda.dibra@unishk.edu.al

Doc. Ridvan Dibra

ridvan.dibra@unishk.edu.al

Dr. Gëzim Puka

gezim.puka@unishk.edu.al

Doktorant Ardian Hoti

ardian.hoti@unishk.edu.al

Doktorant Ismet Kallaba

ismet.kallaba@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I HISTORISË

### ***Përgjegjës i departamentit***

Prof.as.dr. Nertila Ljarja

nertila.ljarja@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof. as. dr. Simon Lufi

simon.lufi@unishk.edu.al

Dr. Bendis Kraja

bendis.kraja@unishk.edu.al

Dr. Sereta Koperaj

sereta.koperaj@unishk.edu.al

Msc. Anelmo Spahija

anelmo.spahija@unishk.edu.al

Dr. Marsel Nilaj

marsel.nilaj@unishk.edu.al

Dr. Brunilda Duriçi

brunilda.durici@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË

### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Bresena Kopliku

bresena.kopliku@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof. as. dr. Nevila Dibra

nevila.dibra@unishk.edu.al

Dr. Flora Gjoni

flora.gjoni@unishk.edu.al

Dr. Dritan Rustja

dritan.rustja@unishk.edu.al

Dr. Ervis Krymbi

ervis.krymbi@unishk.edu.al

Dr. Nertila Dilaveri

nertila.dilaveri@unishk.edu.al

Prof. as. dr. Medion Hysenaj

medion.hysenaj@unishk.edu.al

## QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

### ***Drejtor i qendrës***

Dr. Zamira Shkreli

zamira.shkreli@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të qendrës***

Prof. dr. Artan Haxhi

artan.haxhi@unishk.edu.al

Prof. dr. Alfred Çapaliku

alfred.capaliku@unishk.edu.al

Dr. Erzen Koperaj

erzen.koperaj@unishk.edu.al

Dr. Ermira Aliaj

ermira.aliaj@unishk.edu.al

Dr. Isida Hoxha

isida.hoxha@unishk.edu.al

Doc. Bora Logu

bora.logu@unishk.edu.al

## FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

### DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS

#### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Seditë Duraj

sedita.duraj@unishk.edu.al

#### ***Anëtarë të departamentit***

Dr. Besara Mema

besara.mema@unishk.edu.al

Dr. Sedita Duli

sedita.duli@unishk.edu.al

Msc. Irma Kopliku

irma.kopliku@unishk.edu.al

Msc. Arsen Zlatiçanin

arsen.zlaticanin@unishk.edu.al

Msc. Dritan Gërbeti

dritan.gerbeti@unishk.edu.al



Msc. Fatjona Kroni  
Msc. Volfrida Toma  
Msc. Helga Sallaku  
Dr. Arben Lluji

fatjona.kroni@unishk.edu.al  
volfrida.toma@unishk.edu.al  
helga.sallaku@unishk.edu.al  
arben.lluji@unishk.edu.al

## **DEPARTAMENTI I FIZIKËS**

### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Edra Fresku

edra.fresku@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof.as.dr. Florian Mandija  
Msc. Senada Jubica  
Msc. Suela Serani  
Doc. Zenel Lohja  
Dr. Julia Preka  
Dr. Brunilda Lufi

florian.mandija@unishk.edu.al  
senada.jubica@unishk.edu.al  
suela.serani@unishk.edu.al  
zenel.lohja@unishk.edu.al  
julia.preka@unishk.edu.al  
brunilda.lufi@unishk.edu.al

## **DEPARTAMENTI I BIOLOGJI- KIMISË**

### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Prof.as.dr. Ariana Laçej

ariana.lacej@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof.dr. Suzana Golemi  
Prof.dr. Anila Neziri  
Prof.as.dr. Rrok Smajlaj  
Prof.as.dr. Violeta Alushi  
Prof.as.dr. Neira Medja  
Prof.as.dr. Anila Dizdari  
Dr. Arselida Mashaj  
Dr. Aurora Dibra  
Msc. Donalda Laçej

suzana.golemi@unishk.edu.al  
anila.neziri@unishk.edu.al  
rrok.smajlaj@unishk.edu.al  
violeta.alushi@unishk.edu.al  
neira.medja@unishk.edu.al  
anila.dizdari@unishk.edu.al  
arselida.mashaj@unishk.edu.al  
aurora.dibra@unishk.edu.al  
donalda.lacej@unishk.edu.al

## **QENDRA E STUDIMIT TË UJËRAVE TË RAJONIT SHKODËR**

### ***Drejtor i qendrës***

Prof. as. Marash Rakaj

marash.rakaj@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të qendrës***

Prof.dr. Adem Bekteshi

adem.bekteshi@unishk.edu.al

Dr. Nevilë Bushati  
Dr. Diana Kapiti  
Dr. Lulzime Dhora

nevile.bushati@unishk.edu.al  
diana.kapiti@unishk.edu.al  
lulzime.dhora@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

### ***Përgjegjës i departamentit***

Doc. dr. Emiljano Pjetri

emiljano.pjetri@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof.as.dr. Zamira Shabani

zamira.shabani@unishk.edu.al

Dr. Irena Shala

irena.shala@unishk.edu.al

Doc. dr. Julian Kraja

julian.kraja@unishk.edu.al

Doc. Valbona Dibra

valbona.dibra@unishk.edu.al

Dr. Kilda Gusha

kilda.gusha@unishk.edu.al

Msc. Kristian Preçetaj

kristian.precetaj@unishk.edu.al

Msc. Luljeta Jaku

luljeta.jaku@unishk.edu.al

Msc. Sebastjan Mjekaj

sebastjan.mjekaj@unishk.edu.al

Msc. Silvana Belisha

silvana.belisha@unishk.edu.al

Msc. Vera Gjinaj

vera.gjinaj@unishk.edu.al

Msc. Xheorxhina Frroku

xheorxhina.frroku@unishk.edu.al

Msc. Arketa Pllumbi

arketa.pllumbi@unishk.edu.al

## FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

### DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË DHE PUNËS SOCIALE

#### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Visar Dizdari

visar.dizdari@unishk.edu.al

#### ***Anëtarë të departamentit***

Prof. as. Fatbardha Osmanaga

fatbardha.osmanaga@unishk.edu.al

Dr. Brilanda Lumanaj

brilanda.lumanaj@unishk.edu.al

Dr. Lediana Xhakollari

lediana.xhakollari@unishk.edu.al

Dr. Galsvinda Biba

galvinda.biba@unishk.edu.al

Dr. Arben Hoti

arben.hoti@unishk.edu.al

Dr. Bujanë Topalli

bujane.topalli@unishk.edu.al

Dr. Elona Hasmuajaj

elona.hasmuajaj@unishk.edu.al

Dr. Adelina Kakija  
Dr. Jonida Lesha  
Msc. Elidjon Cami

adelina.kakija@unishk.edu.al  
jonida.lesha@unishk.edu.al  
elidjon.cami@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I MËSUESISE

### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Eranda Bilali

eranda.bilali@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof.as.dr. Fatmir Vadohej

fatmir.vadohej@unishk.edu.al

Dr. Pranvera Kraja

pranvera.kraja@unishk.edu.al

Dr. Rina Muka

rina.muka@unishk.edu.al

Doc. Roland Guli

roland.guli@unishk.edu.al

Msc. Andi Hila

andi.hila@unishk.edu.al

Dr. Arlinda Ymeri

arlinda.ymeri@unishk.edu.al

Dr. Migena Kecaj

migena.kecaj@unishk.edu.al

Msc. Megi Vjerdha

megi.vjerdha@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTEVE

### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Gjulio Zefi

gjulio.zefi@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Dr. Nora Deda

nora.deda@unishk.edu.al

Dr. Artan Kalaja

artan.kalaja@unishk.edu.al

Dr. Benjamin Naku

benjamin.naku@unishk.edu.al

Dr. Fatjon Nurja

fatjon.nurja@unishk.edu.al

Msc. Gentiana Nicaj

gentiana.nicaj@unishk.edu.al

Msc. Erjon Peqini

erjon.peqini@unishk.edu.al

Msc. Ermal Milla

ermal.milla@unishk.edu.al

Msc. Arbana Bekteshi

arbana.bekteshi@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I ARTEVE

Përgjegjës i departamentit

Dr. Rubin Mandija

rubin.mandija@unishk.edu.al

Dr. Nevila Bushati  
Dr. Lulëzime Dhora  
Dr. Diana Kapiti  
Dr. Hajrie Dibra

nevila.bushati@unishk.edu.al  
lulezime.dhora@unishk.edu.al  
diana.kapiti@unishk.edu.al  
hajrie.dibra@unishk.edu.al

## FAKULTETI I DREJTËSISË

### DEPARTAMENTI I TË DREJTËS PUBLIKE

#### *Përgjegjës i departamentit*

Dr. Roland Dodani

[roland.dodani@unishk.edu.al](mailto:roland.dodani@unishk.edu.al)

#### *Anëtarë të departamentit*

Dr. Emanuela Furramani  
Prof.as.dr. Entela Baci  
Msc. Ermira Kulluri  
Dr. Gaspër Kokaj  
Prof.as.dr. Irma Baraku  
Prof. as.dr. Paulina Guli

emanuela.furramani@unishk.edu.al  
entela.baci@unishk.edu.al  
ermira.kulluri@unishk.edu.al  
gasperkokaj@unishk.edu.al  
irma.baraku@unishk.edu.al  
paulina.hoti@unishk.edu.al

### DEPARTAMENTI I TË DREJTËS CIVILE

#### *Përgjegjës i departamentit*

Dr. Eugena Bisha

[eugenabisha@unishk.edu.al](mailto:eugenabisha@unishk.edu.al)

#### *Anëtarë të departamentit*

Dr. Adrian Leka  
Prof.as.dr. Florian Bjanku  
Msc. Florinda Arrinaj  
Dr. Ildir Duhaxhi  
Msc. Xhuana Abazi  
Dr. Yllka Rupa

ardian.leka@unishk.edu.al  
florian.bjanku@unishk.edu.al  
florinda.arrinaj@unishk.edu.al  
idilir.duhaxhi@unishk.edu.al  
xhuana.abazi@unishk.edu.al  
yllka.rupa@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE EUROPIANE

### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Senada Reçi

senada.reci@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Msc. Arenca Trashani

arenca.trashani@unishk.edu.al

Dr. Merisë Rukaj

merisa.rukaj@unishk.edu.al

Msc. Rosalba Basho

rosalba.basho@unishk.edu.al

Dr. Luljeta Zefi

luljeta.zefi@unishk.edu.al

## FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

### DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE

### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Albana Hadri

albana.hadri@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof.as.dr. Rajmonda Këçira

rajmonda.kecira.@unishk.edu.al

Dr. Arben Bushgjokaj

arben.bushgjokaj@unishk.edu.al

Dr. Dalila Karakaci

dalila.karakaci@unishk.edu.al

Dr. Ilda Erkoçi

ilda.erkoçi@unishk.edu.al

Prof.as.dr. Meri Guli

meri.guli@unishk.edu.al

Msc. Nivis Deda

nivis.deda@unishk.edu.al

### DEPARTAMENTI I GJERMANISTIKËS

### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Karmen Lazri

karmen.lazri@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof.as.dr. Edlira Bushati

edlira.bushati@unishk.edu.al

Prof.as.dr. Angjelina Shllaku

angjelina.shllaku@unishk.edu.al

Msc. Erza Cermjani

erza.cermjani@unishk.edu.al

Msc. Irini Dibra

irini.dibra@unishk.edu.al

Msc. Klaudia Darragjati

klaudia.darragjati@unishk.edu.al

Msc. Valjeta Gjylbegaj

valjeta.gjylbegaj@unishk.edu.al

Msc. Ilda Hoxha

ilda.hoxha@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I ROMANISTIKËS

### ***Përgjegjës i departamentit***

Prof.as.dr. Eliana Laçe

eliana.lacej@unishk.edu.al

### ***Anëtarë të departamentit***

Prof.as.dr. Alma Hafizi

alma.hafizi@unishk.edu.al

Prof.as.dr. Dhurata Hoxha

dhurata.hoxha@unishk.edu.al

Dr. Alva Dani

alva.dani@unishk.edu.al

Dr. Aterda Lika

aterda.lika@unishk.edu.al

Dr. Lindita Kazazi

lindita.kazazi@unishk.edu.al

Dr. Drita Brahimi

drita.brahimi@unishk.edu.al

Msc. Aurela Voci

aurela.voci@unishk.edu.al

Msc. Ingrid Tirana

ingrit.tirana@unishk.edu.al

Arita (Laçe) Mjetaj

arita.mjetaj@unishk.edu.al

Celia Paparuso

celia.paparuso@unishk.edu.al

## FAKULTETI EKONOMIK

### DEPARTAMENTI I ADMINISTRIM-BIZNESIT

#### ***Përgjegjës i departamentit***

Dr. Ylvije Kraja

ylvije.kraja@unishk.edu.al

#### ***Anëtarë të departamentit***

Prof.as.dr. Albana Boriçi

albana.borici@unishk.edu.al

Prof.as.dr. Ardita Boriçi

ardita.borici@unishk.edu.al

Dr. Alba Berberi

alba.berberi@unishk.edu.al

Dr. Arjola Halluni

arjola.halluni@unishk.edu.al

Dr. Brikenë Dionizi

brikena.dionizi@unishk.edu.al

Dr. Emirjeta Bejleri

emirjeta.bejleri@unishk.edu.al

Dr. Nevila Mehmetaj

nevila.mehmetaj@unishk.edu.al

Dr. Mario Çurçija

mario.curcija@unishk.edu.al

Dr. Elvira Drishti

elvira.drishti@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT

### *Përgjegjës i departamentit*

Prof.as.dr. Elidiana Bashi

elidiana.bashi@unishk.edu.al

### *Anëtarë të departamentit*

Prof.dr. Elez Osmanoviq

elez.osmanoviq@unishk.edu.al

Prof.dr.Fatbardha Molla

fatbardha.molla@unishk.edu.al

Prof.as.dr. Blerta Dragusha

blerta.dragusha@unishk.edu.al

Prof.as.dr. Ermira Kalaj

ermira.kalaj@unishk.edu.al

Dr. Albana Kastrati

albana.kastrati@unishk.edu.al

Dr. Aurora Kinka

aurora.kinka@unishk.edu.al

Dr. Erjolë Barbullushi

erjola.barbullushi@unishk.edu.al

Dr. Kleida Heta

kleida.heta@unishk.edu.al

Dr. Nevila Kiri

nevila.kiri@unishk.edu.al

Dr. Petër Saraçi

peter.saraci@unishk.edu.al

Msc. Irsida Kopliku

irsida.kopliku@unishk.edu.al

## DEPARTAMENTI I TURIZMIT

### *Përgjegjës i departamentit*

Prof.as.dr. Mirjam Dibra

mirjam.dibra@unishk.edu.al

### *Anëtarë të departamentit*

Prof. dr. Arjeta Troshani

arjeta.troshani@unishk.edu.al

Prof.as.dr. Brilanda Bushati

brilanda.bushati@unishk.edu.al

Dr. Alkida Hasaj

alkida.hasaj@unishk.edu.al

Dr. Romina Dhora

romina.dhora@unishk.edu.al

Dr. Rudin Beka

rudin.beka@unishk.edu.al


Msc. Sead Baraku

sead.baraku@unishk.edu.al

Msc. Arian Gjura

arian.gjura@unishk.edu.al









Ky projekt për orientimin e studentëve të vitit të parë në Universitetin e Shkodrës, u realizua nga **Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**.



## UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI"

Adresa: Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi",  
Rektorati, Sheshi 2 Prilli, Shkodër, Albania  
P.O.BOX 4001

Kontakt: Email-info@unishk.edu.al

Telefon: +355 (22) 800 651

Website: www.unishk.edu.al



[Universiteti.luigj.gurakuqi](https://www.instagram.com/Universiteti.luigj.gurakuqi)



[Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"](https://www.facebook.com/Universiteti.i.Shkodrës.Luigj.Gurakuqi)



16.12.2021